

TAKIME NË KUADËR TË PËRFSHIRJES SË TRYEZAVE PPIE

Në kuadër të përgatitjeve për procesin e negociatave për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, gjatë vitit 2026, Ministria e Punëve të Brendshme ka planifikuar të organizojë një sërë tryezash diskutimi në kuadër të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian (PPIE), të fokusuara në Kapitullin 24 “*Drejtësia, Liria dhe Siguria.*”

Në kalendarin e aktiviteteve të PPIE-së sipas kapitullit në drejtimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, do të gjeni temat që do të trajtohen gjatë vitit 2026.

Ndër çështjet kryesore për diskutim si vijon:

QERSHOR 2026

- Konsultim mbi Strategjinë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Personave 2026 – 2030;

SHTATOR 2026

- Diskutim mbi projektligjin “Për tregtimin dhe përdorimin e prekursorëve shpërthyes”;

NËNTOR 2026

- Konsultim mbi Strategjinë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2026–2030 dhe planet përkatëse të veprimit 2026–2028;

DHJETOR 2026

- Diskutim mbi projektligjin “Për adresimin e përhapjes së përmbajtjeve terroriste në internet”.